



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



KA/Nr. 1069/22 Datë: 15.08.22

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D, ta datës 04.09.2020 dhe vendimin 732/22D të datës 03.06.2022 në përbërje të plotë; Faton Berisha kryetar, Muhamet Qerimi anëtarë dhe Haki Demolli anëtarë/rezervë, në prani të procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës së Akademia Tempulli me nr.3158/21H të pranuar me datë 07.09.2021, kundër vendimit të KSHC Ref;3035/21 të nxjerrë me datë 12.08.2021 për zgjatjen e afatit të akreditimit nga dy (2), në tre (3) vite për programin; Sigurimet dhe Menaxhimi i Dëmeve nga Aksidentet, BA Profesional,180 ECTS, me specializime: 1. Sistemet e Sigurimeve, 2. Vlerësues i Dëmeve, 3. Logjistika dhe Shpedicioni, maksimumi 60 studentë për vit akademik. Në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Rregullores Nr.2/2019 për procedurën e ankesave në Komisionin e ankesave pran AKA si dhe Manualit të Akreditimit, në mbledhjen e datës 25.07.2022, merr:

VENDIM

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa e Akademia Tempulli me nr.3158/21H, datë 07.09.2021.
- II. I propozohet Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim të ndryshoj vendimin nr. Ref;3035/21 të nxjerrë me datë 12.08.2021, në paragrafin I, paragrafi 1, **(zgjatet afati i akreditimit nga dy (2) vite sa ishte me këtë vendim, në tri (3) vite).**
- III. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komisionit.

ARSYETIM

Akademia “Tempulli”, në afatin ligjor ka parashtruar ankesë me nr.3158/21H, datë 07.09.2021, kundër vendimit të KSHC nr.Ref;3035/21 të nxjerrë me datë 12.08.2021 për zgjatjen e afatit të riakreditimit nga dy (2), në tre (3) vite për programin;

- Sigurimet dhe Menaxhimi i Dëmeve nga Aksidentet, BA Profesional, 180 ECTS, me specializime: 1. Sistemet e Sigurimeve, 2. Vlerësues i Dëmeve, 3. Logjistika dhe Shpeditoni, maksimumi 60 studentë për vit akademik,

Ankuesi në ankesë pretendon se KShC me vendimin Nr.Ref:3035/21, datë 12.08.2021 ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 19, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018, datë 28.09.2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

KShC pas pranimit të ankesës bazuar në nenin 131 të Ligjit Nr. 05/1.-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pa u shprehur mbi të, të njëjtën e ka përcjellë në Komisionin e Ankesave të AKA-së bazuar në paragrafin 5 të nenit 131 të Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Akademinë "Tempulli", me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizita është organizuar më 25.05.2021, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Tauno Otto, Marija Vasilevska.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Sigurimet dhe menaxhimi i dëmeve nga aksidentet, BA Profesional, 180 ECTS, - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht katër (4), dhe pjesërisht tri (3).

Komisioni i Ankesave, pas mbledhjes konstitutive të mbajtur me datë 09.06.2022 njëzëri ka vendosur që të shqyrtoj të gjitha ankesat e parashtuara nga IAL-të për periudhën sa nuk ishte funksional.

Komisioni i ankesave i AKA-së gjatë shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova:

- Ankesë kundër vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë nr.3158/21H, datë 07.09.2021
- Vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC), Nr.Ref:3035/21, datë 12.08.2021
- Raporti përmbledhës i KShC-së për ankesën
- Raporti i Ekipit të Ekspertëve të datës 15.06.2021

Pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të lartcekura komisioni ka gjetur se në Raportin e Ekipit të Ekspertëve të datës 15.06.2021, në rekomandimin përfundimtar, ekspertët rekomandojnë akreditimin e programit të lartëcekur, citojmë

*"In conclusion, the Expert Team considers that the study program Insurances and Management of Damages from Accidents offered by Tempulli Academy is Substancially complaint with the standards included in the KAA Accreditation manual and therefore, recommends accredit the study program for a duration of **three years with a number of 60 students to be enrolled in the program**".*

Komisioni i Ankesave i AKA-së pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave dhe provave të lëndës, pretendimeve të palës ankuese, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe se KShC-së me Vendimin i Nr.Ref:3035/21, datë 12.08.2021 me të cilin;

Akreditohet programi i studimit i Akademisë “Tempulli”, për periudhën dy (2) vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2023:

- *Sigurimet dhe Menaxhimi i Dëmeve nga Aksidentet, BA Profesional, 180 ECTS, me specializime: 1. Sistemet e Sigurimeve, 2. Vlerësues i Dëmeve, 3. Logjistika dhe Shpedicioni, maksimumi 60 studentë për vit akademik,*

nuk ka aplikuar drejtë nenin 19 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 15/2018, me ç'rast Komisioni Ankesave konstatoi se referuar raporteve të lartcekur janë plotësuar kushtet për Riakreditim për programet e studimit të lartcekura për periudhën **tre (3) vjeçare, 01 tetor 2021 - 30 shtator 2024.**

Komisioni Ankesave i AKA, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, provave të ofruara, si dhe analizimit të të gjitha pretendimeve të palës ankuese, ka konstatuar se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës janë të qëndrueshme dhe të bazuara, andaj duke u bazuar në kompetencat e Komisionit të Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të filloj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore Prishtinë-Departamenti për çështje administrative. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës.

Komisioni Ankesave i Agjencisë së Kosovës për Akreditim

Lënda nr.Ref.: 1069/22 datë 15.08.22


Leona Kovaçi

Procesmbajtëse

Vendimi iu dërgohet:

- Ankuesit;
- KShC-së;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Faton Berisha

Kryetar i Komisionit të Ankesave të AKA